

VENDIM
Nr.56, datë 21.1.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË,
PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE “UFO DENTAL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare private “UFO dental”, Tiranë, për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

- a) Gazetari, me profil:
 - i) Marrëdhënie me publikun dhe marketing;
 - ii) Drejtim dhe menaxhim i mediave;
 - iii) Gazetari ndërkombëtare.
- b) Marrëdhënie ndërkombëtare, me profil:
 - i) Politika e jashtme dhe diplomacia;
 - ii) Integrim evropian;
 - iii) Studime ballkanike, studime për sigurinë.
- c) Administrim publik, me profil:
 - i) Pushtet ekzekutiv;
 - ii) Qeverisje vendore;
 - iii) Hapësira publike evropiane;
 - iv) Politika dhe menaxhimi shëndetësor
- ç) Menaxhim bankar;
- d) Administrim biznesi.

2. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit, të ciklit të dytë, do të jetë 2 vite akademike, me plotësimin, së paku, të 120 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë e nivelit të dytë (DND), në fushën e arsimimit të kryer.

3. Lejimin e shkollës së lartë universitare private “UFO dental”, me seli në Tiranë, për hapjen e programit të studimit “Master i nivelit të parë”, në:

- a) e drejta tregtare.

4. Programi i studimit “Master i nivelit të parë” është pjesë e studimeve të ciklit të dytë, me, së paku, plotësimin e 60 krediteve. Në mbarim të programit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë” (MNP) në fushën e arsimimit dhe të trajnimit të kryer.

5. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private “UFO dental”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga një personel akademik, me kualifikimin e nevojshëm dhe sipas specialitetit.

6. Shkolla e lartë universitare private “UFO dental”, do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 1 e 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të veprimtarisë mësimore, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

7. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. Shkolla e lartë universitare private “UFO dental”, duhet t’i nënshtrohet procesit të

akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

9. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha